



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR MEDIA DHE INFORMIM
Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Nr. 262/1 Prot.

Tiranë, më 26.5 2025

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
PËR AGJENCINË PËR MEDIA DHE INFORMIM**

Periudha e raportimit : Janar – Prill 2025

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit nr. 14, datë, 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 4 -mujorit për vitin 2025.

Agjencia për Media dhe Informim, për vitin 2025 i është akorduar fondi buxhetor, sipas programit të miratuar, konkretisht:

1150 Shërbime të tjera

Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve të përgjithshme të Agjencisë për Media dhe Informim, dhe përmirësimin e infrastrukturës së saj. Buxheti total i alokuar për Agjencinë për Media dhe Informim, për vitin 2025, si dhe ndryshimet pas rishikimit të tij, paraqiten si më poshtë :

(Në 000/Lekë)

Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti Fillestar i vitit 2025	Buxheti Rishikuar i vitit 2025	Plan Janar - Prill 2025	Fakti Janar – Prill 2025
Shpenzime Totale	150,112	0	53,400	38,021

Buxheti fillestar për vitin 2025, i planifikuar për këtë program, është 150,112 (në 000/Lekë).Plani për priudhën Janar - Prill 2025 është 53,400 lekë.Realizimi faktik për priudhën Janar - Prill 2025 është 38,021 (në 000/Lekë), që përbën 71 % të planit 4- mujor.

Realizimi i shpenzimeve Janar - Prill për këtë program, sipas zërave kryesorë paraqitet si më poshtë:

(Në 000/Lekë)

Emërtimi i zërave të buxhetit	Buxheti Fillestar i vitit 2025	Buxheti i Rishikuar i vitit 2025	Buxheti i çelur i 4-mujorit 2025	Realizimi në vlerë absolute	Realizimi në vlerë përqindje
Paga	114,562	0	39,600	31,887	81 %
Sigurime Shoqërore	19,150	0	6,400	5,150	81 %
Mallra dhe shërbime të tjera	15,000	0	7,000	918	13 %
Transferta për buxhet Familjar dhe Individ	400	0	400	66	17 %
Blerje pajisje dhe orendi	1,000	0	0	0	0
TOTALI	150,112	0	53,400	38,021	71 %

Përshkrimi i Shpenzimeve dhe Produktit të Programit:

Ky program përfshin financimin për pagat e punonjësve të Agjencisë për Media dhe Informim, si dhe shpenzime për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efektivitetit të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme (energji, karburant, telefon, etj.). Këto shpenzime janë të lidhura ngushtë me përmbushjen e detyrave të Agjencisë dhe përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese të saj. Numri

i punonjësve buxhetore të miratuar sipas planit vjetor është 69 dhe numri faktik është 63 nga ai i planifikuari.

Tregues me bazë gjinore

Numri i vajzave dhe grave në total është 43, të cilat përbëjnë 70% të organikës, 4 janë në nivel drejtuese.

Realizimi i Produktit të Parashikuar për 2025:

Produkti i Agjencisë për Media dhe Informim është **Komunikimi dhe Informimi Mediatic (Kodi 98704AN)**. Ky produkt ka një buxhet të planifikuar prej 53,400 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 38,021 mijë lekë, që përbën 71 % të planifikimit.

Konkluzione:

Nga realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Prill 2025, mund të konkludohet se objektivi i politikës për menaxhimin efektiv të buxhetit dhe zbatimin e suksesshëm të programit është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ALTEO HYSI



REPUBLICA E SHQIPËRIE - VIKTORIA
AGJENCIA PËR MEDIA DHE INFORMIM
MINISTRIA E KULTURËS DHE IDENTITETIT